

## EKSTRAKT NGA PROCESVERBALI

I mbledhjes së V I-të të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ( KKSb) në Komunën e Obiliqit, të mbajtur më 20.11.2018 në ora 11:00 , në sallën e KK-së.

**Në mbledhje morën pjesë këta anëtarë:** Kryetari i Komunës-Xhafer Gashi, Komandanti i SP-Sejdi Zeqiri, përfaq. i FSK-major I.Demiri, përfaq.i komun.ortod. Naspaliq Aleksander, përfaq.kom.serb.- Slavisha Jakovljeviq, përfaq.i komun.boshnjak-Lejla Boshnjak, drejtor i DMM-Arben Berisha, drejtori i DA -Agim Spahiu, Kryetari i KLSP- sekt.I-re-Burim Gërguri, përfaq.i Kësh.të prind.-Fatmir Bërbatovci, përfaq.kom.rom-Shaban Berisha, zyrtari i emergj.-Valon Berisha, Qendra Rinore-Zelushe Kelmendi, Eljesa Tërbunja-Handikos, EVSB-Sejdi Haxholli, OJQ "Aureola"- Sanije Graiçevci, ZKKK- Sllavisha Agjanqiq, Kryetar i K. Komunitete-Avdyl Mustafa, përfaq.i kom.malaz.-Jasmina Radanoviq, zyrt.baraz.gjinor-Ganimete Aliu dhe koordinator i KKSb - S. Hashani.

**Munguan:** perf.i BIK-I.Hashani

**Prezent të tjerë:** përfaqësues të KFOR-it dhe OSBE-së

Mbledhjen e udhëhoqi Kryesuesi i KKSb-Xhafer Gashi, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi se ka kuorum për të filluar mbledhjen me këtë:

### REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Gjendja e sigurisë në Komunën e Obiliqit
4. Të ndryshme

**Kryetari-** Pasi i përshëndeti të pranishmit dhe para se të kalohet në r.d. i njoftoi të pranishmit se Komandanti i policisë gjendet në një takim zyrtarë por në ndërkohe do të na bashkëngjitet në mbledhje.


#### I. Pika e parë e rendit të ditës.

**Mungoi :** perf.i BIK-I.Hashani.

#### II. Pika e dytë e rendit të ditës-

Pasi nuk pat vërejtje nga të pranishmit njëzëri:

**Aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.**



#### III. Pika e tretë e rendit të ditës-

**Komandanti i SP-S.Zeqiri-** të pranishmit i njoftoi se situata e sigurisë në Komunën e Obiliqit është relativisht e qetë përkundër që ka mungesë të personelit dhe se shpreson se kjo do të rregullohet. Ai njoftoi për disa nga rastet në dy muajt e fundit:

- njëri prej rasteve ishte në datën 27.09.2018 vjedhje e rëndë në tentativë ku në grup hajdutësh në fshatin Mazgit kanë tentuar që të bëjnë një plaçkitje dhe kanë qenë të armatosur mirëpo falë angazhimit të SP- Obiliqit dhe zyrtarëve policorë iu janë përgjigjur thirrjes në bazë të informatës që kanë marr dhe personat e dyshuar janë kapur në flagrancë dhe është konfiskuar një veturë Renta car nga komuna e Gjilanit ndërsa të dyshuarit ishin nga komunat e Malishevës, Podujevës, Drenicës dhe Lipjanit. Ky rast është në procedim e sipër.

- Ndërsa raste të tjera janë më shumë raste të armëmbajtjes pa leje si armë të ftohta dhe armë të zjarra.

- Me 03.10.2018 në qytetin e Obiliqit ka pasur një rrahje nga një grup të rinjsh të cilët janë sjellë në stacionin policor dhe janë intervistuar disa nën prezencën e QPS-së dhe avokatëve mbrojtës disa të tjerë që kanë qenë të moshës madhore dhe ndaj tyre janë konfiskuar disa armë të ftohta rasti ka kaluar në procedurë në prokurori dhe është ngritur kallëzim penal për prishje të rendit dhe qetësisë publike, armëmbajtje në pronësi, përdorim i paautorizuar i armës dhe sprejit, lëndimet kanë qenë të lehta trupore dhe nuk ka ndonjë reagim mjekësor me lëndime të renda.



- Rast tjetër ka qenë një kanosje që ka ndodhur në fshatin Lajthishë ku një qytetar, një punëtorë i KEK-ut ka kërcënuar rojën e KEDS-it për arsye se ata në një mendre e kanë parandaluar që të bëjë ndonjë gjë të paligjshme. Personi i dyshuar është sjellë në stacion me urdhër të prokurorit, është kontrolluar shtëpia e tij dhe në shtëpinë e tij është gjetur një armë dhe është konfiskuar. Rasti ka proceduar në prokurori për veprime të mëturjeshme.

- Njëkohësisht kemi pasur një mosmarrëveshje në familjen Rexhepi, ku ka poseduar armëmbajtje pa leje, kontrollim, posedim të armës dhe policia ka reaguar shumë shpejt dhe në bazë të asaj kemi konfiskuar një revole.

- Po ashtu gjatë pikës së kontrollit në fshatin Milloshevë, njësi e SP-Obiliq ka bërë një pikë kontrolli dhe ka hasur në një veturë një person i cili gjatë kontrollit është gjetur një armë është dërguar në SP-së ndërsa rasti si rast është armëmbajtje në pronësi, kontroll, posedim i paautorizuar të armës dhe shkaktim i rrezikimit të përgjithshëm. Janë konfiskuar 155 fishekë të kalibrit 12 mm njëkohësisht është konfiskuar edhe një armë magnum numër serik i jashtëm.

- Po ashtu kemi pasur edhe një rast dhune në familje me 31.10.2018 mbajtje në pronësi kontroll që bashkëshortja e ka paraqitur rastin se ka pasur dhunë në familje në mes bashkëshorteve, njësi e policore kanë reaguar shumë shpejtë, kemi shkuar i kemi identifikuar personin e dyshuar dhe në bazë të asaj personi i dyshuar është sjellë në SP-Obiliq, është kontrolluar shtëpia dhe është gjetur një armë zjarri njëkohësisht 7 fishekë dhe një revole, ndërsa bashkëshortja është dërguar në Qendrën për mbrojtje nga dhuna familjare dhe është duke u trajtuar në mënyrë të mundshme.

- Njëkohësisht në pikën e kontrollit në fshatin Millosheve gjatë pikës së kontrollit edhe një rast kemi pasur armëmbajtje pa leje në pronësi të paautorizuar dhe gjatë kontrollimit është hasur që njësit tona kanë arritur që të konfiskojnë një revole, karikatorë dhe disa plumba.

- Lëndimi i lehtë truporë tjetër i cili ka pasur ka qenë që duhet të potencojë veçanërisht në fshatin Lajthishtë në shkollën fillore F.Graiqevci ka ndodhur një rast ditë më parë ku është rrahur një nxënës nga arsimtari i lëndës së teknologjisë në kemi shkuar dhe kemi reaguar shumë shpejtë kemi shkuar dhe kemi bisedua me drejtorin e shkollës njëkohësisht SP i Obiliqit njësi për hetime është duke u trajtuar rastin në mënyrë të mirë të mundshme njëkohësisht se bashku me QPS-në jemi përgatitur që të intervistojmë disa nxënës për shkak që janë të mitur moshës se mitur që të karakterizojmë në cilësinë e dëshmitarit verbal jo me shkrim për arsye se janë të mitur ndërsa kërkoj nga drejtoria e arsimit njëkohësisht edhe nga strukturat e tjera nuk e di sa janë të njoftuar por me sa di unë janë të njoftuar strukturat relevante por kisha kërkuar bashkërisht edhe me drejtorin e DA-së të punojmë në këtë proces për arsye se sipas mendimit tim është një rast që duhet trajtuar në mënyrë të mirë dhe është një rast mjaft sensitiv që kërkon trajtim,

- po ashtu gjatë këtyre dy muajve kemi pasur shqiptim të tiketave, shqiptime mandatorë, kemi pasur 7 aksidente që është një rezultat mjaft i mirë nga SP i Obiliqit. Të gjitha aksidentet kanë qenë me dëme materiale, nuk kemi asnjë rast fatal apo me lëndime të rënda trupore që mendoj që është një rezultat dhe një preventive e mirë nga SP i Obiliqit.

- Këto ditë jemi para një sfide bukur të madhe para pranimit në Interpol në kemi shtuar orarin e punës d.m.th nga 12 orë në dy turne. Jemi mjaft të angazhuar por pavarësisht asaj punët dhe detyrat janë duke u karakterizuar në mënyrë të mirë të mundshme dhe falë këtij angazhimi dhe këtij plani operativ që ne kemi hartuar kemi arritur mjaft që të reduktojmë numrin e vjedhjeve dhe të rasteve tjera andaj uroj që kjo punë të vazhdojë edhe më tutje ndërsa uroj që kjo sfida e madhe që është para nesh të kalojë pa ndonjë problem për shkak se niveli i rrezikshmërisë është i ulët kah i mesëmi, po shpresoj edhe besoj se këto dy ditë që na kanë mbetur do të kalojmë mirë nuk do të ketë ndonjë problem.

**Kryesuesi-** Sa për sqarim të ju njoftoj çështja e shkollës që e përmende me mësimdhënësin, ne e kemi si informate dhe drejtoria dhe komisionet përkatëse janë duke u trajtuar si rast dhe besoj që ne mbledhjen e radhës meqë s'është drejtori këtu na njofton çka ka ndodhur, por është në procedurë. Shqetësim tjetër që ne e kemi dhe besoj që është edhe i gjithë juve janë çështja ambientale, është nisja e aksionit prej 15 nëntorit edhe pse ne i kemi pasur edhe dy aksione të mëhershme në prill dhe një në qershor mirëpo tani me aktet përcjellëse aktet nënligjore, aktet administrative është plotësuar edhe pjesa e mundësisë së gjobave, kisha kërkuar që bashkërisht me inspektionin e nivelit lokal dhe nivelit qendror bashkërisht me policinë të koordinohen që keqbërësit të cilët prapë po vazhdojnë me hedhjen e mbeturinave të gjobitën. Shqetësim tjetër e kemi e jemi mundu edhe në mënyrë të tjera



me përcjell si mesazh neper shkolla dhe neper xhamia rreth djegieve te sërnishtave ose barishtave te thata qe po ndikojnë keq edhe ne djegien e drunjve. Ne e falënderojmë policinë dhe inspektionin ne këtë rast te ambientit, disa raporte i kanë përgatit dhe i kanë drejtuar, është përgatit edhe një fletushke me qellim qe te sensibilizohet opinioni ne këtë drejtim por si duket pak po ka efekt kështu qe do te ishte mire qe bashkërisht prapë mu mundu me qene sa ma shumë aktiv për me mund mi ndalu. Unë e di komandant për punën e madhe qe jeni duke e bërë dhe e di qe numerikisht ende jeni pak, ju përgëzoj për punën e madhe qe jeni duke e bërë, po vërehen ndryshimet dhe po vërehen patrullat ne vazhdimësi edhe ne hyrje dalje te qytetit. Unë besoj qe shumë shpejt ke me u plotësu edhe me numrin shtesë te policëve, te paktën kështu e kemi premtimin mbas rekrutimit te kësaj gjeneratës se fundit do te ketë lehtësime edhe për neve. Shqetësim tjetër i kemi edhe qenët endacak , janë duke i trajtua nga veterinarët dhe qeveria e ka nda një fond diku 1 milion e gjysme, qe po merren me trajtimin e tyre. Kemi pas kontakte edhe me Drejtorin e bujqësisë dhe nëse doni herën tjetër mundemi me thirr edhe personat te cilët janë duke u marr me këtë trajtim qe te jenë prezent. Vlen me falënderua shumë edhe FSK-në qe ne çdo aktivitet për mbrojtje të ambientit na kanë mbështet, gjithashtu KEK-u dhe organizatat tjera te cilat na kanë dal ne përkrahje për pastrim te ambientit por tash dua qe te gjithë ne te jemi pak më aktiv ne drejtim te mbrojtjes dhe ruajtjes se këtyre zonave. .

**Komandanti i SP-S.Zeqiri-** sa i përket djegies se mbeturinave dhe stërnishtave, ne fshatin Milloshevë para disa muajve janë djegur mbeturinat e varrezave ortodokse qe gjenden ne fshatin Milloshevë, ne e kemi trajtua këtë rast te veçantë dhe fale angazhimit te hetuesve dhe SP kemi arritur ti identifikojmë personat te cilët i kanë dëmtuar dhe i kanë djeg ato stërnishta dhe ndaj tre është bere kallëzimi penal dhe rasti është dërguar ne prokurori. Kemi edhe raste tjera qe vlen te theksohen sa i përket rastit te djegies se stërnishtave dhe mbeturinave sidomos ne fshatin Breznicë dhe përreth fshatit Milloshevë ku demet materiale janë bukur te theksuara , kemi vlera mbi 10,000 euro ku janë djegur dhe janë dëmtuar disa fidanishte edhe ne fshatin Shipitullë edhe ne fshatin Grabovc dhe te tjera andaj lus edhe me një opinion te veçante edhe pse ka kaluar kjo sezone ndoshta është dashur me herët por herëve te tjera për arsye se është sezon e dimrit besoj qe nuk do te kemi nevojë, por besoj dhe shpresoj qe ne te ardhmen te bëjmë një lloj preventive apo lajmërimi qe qytetaret te vetëdijesohen qe te mos i djegin stërnishtat për arsye se ata i djegin atu afër shtëpisë se tyre mirëpo zjarri shumë shpejt përhapet dhe shpesh herë kemi pasur problem edhe me zjarrfikësit për arsye se kanë qene te angazhuar ne disa raste, ndërsa sa i përket bashkëpunimit me priftin ortodoks dhe strukturat tjera qe janë ne fshatin Babimovc dhe Plemetin vetëm sa për opinionin ne jemi duke e bere sigurimin e kishës ne Babimovc edhe Plemetin, për shkaqe te ndryshme nuk kemi ndonjë informacion qe mund te ketë ndonjë problem ose diçka tjetër mirëpo thjeshte për shkaqe te sigurisë edhe te objekteve fetare por edhe kulteve tjera edhe ne vet qytetin e Obiliqit kështu qe besoj dhe shpresoj qe edhe gjatë këtyre dy ose tri ditëve qe do te bëjmë sigurimin do te kaloj gjithçka ne rregull.

Unë e falënderoj edhe priftin ne bashkëpunim me policinë qe çdo herë ka qene komunikativ por njëkohësisht edhe nënkryetarin shtese Jakovljeviq edhe shefin e zyrës për komunitete S.Agjanqiq.

**S.Jakovljeviq-** Do te doja te ndërlihem me te gjitha këto qe u thane nga komandanti i SP-së dhe nga fjala juaj duke e ditur qe ne territorin e komunës se Obiliqit për sjellën ne qytet dhe ne vendbanime te tjera ka incidente me te vogla gjë qe na gëzon dhe ajo çka është e dukshme është se janë përforcuar patrullat neper vendet sidomos ne vendbanimet ku jetojnë komuniteti jo shumice ne Palaj, ne Babimovc dhe po shihet qe përfaqësuesit e policisë se Kosovës po gjenden edhe pran objekteve fetare qe ta rrisin sigurinë ne komunë dhe ta lehtësojnë punën e shërbimit policorë duke qene se komuna ka një buxhet me te lartë për vitin 2019 dhe ne bisede me z. Haxholli propozoj qe nëse ka mundësi te ndihmojmë ne zgjidhjen e zbatimit te një projekti e kjo është vendosja e video kamerave neper qytet po ashtu edhe te gjitha udhëkryqet e rreth te gjitha shkollave dhe ne te gjitha vendbanimet ne territorin e komunës se Obiliqit. Sa i përket vendbanimeve ose fshatrave propozoj qe kamerat te vendosen ne hyrje dhe ne dalje te fshatrave ne mënyre qe policia e Kosovës ta ketë ne vëzhgim hyrje daljen e qytetareve qe nuk janë banor te komunës se Obiliqit sidomos ne orët e vona ku ekziston mundësia qe te ndodhë ndonjë ngjarje e pakëndshme. Këto i përkrah te gjitha çka u thane nga ana e komandantit te policisë por vetëm propozoj nëse kemi mundësi buxhetore te komunë se bashku me policinë, vitin e ardhshëm ta bëjmë këtë projekt qe te rrisim sigurinë e qytetarëve dhe te vendosim kamerat ne te gjitha lokalitetet e fshatrave .

**Kryesuesi-** Ne e kemi biseduar edhe me z. Haxholli dhe po shpresojmë se këta kanë me vazhdua projektin, vullneti ekziston me vazhdu dhe nëse këta se vazhdojnë ne kemi me gjet forma tjera por un besoj se këta kanë me



vazhdu edhe ne te ardhmen projektin me Burimin. Digjitalizimi ose vendosja e kamerave me te vërtetë si mase preventive ofron mundësi me shumë edhe për kryerjen e detyrës te policisë se Kosovës por edhe për çështjen e sigurisë, ne i dëgjuam raportin e komandantit dhe unë mendoj qe këta kanë me vazhdu dhe i inkurajoj por tani për tani janë me numër te vogël dhe e tha edhe komandanti qe po punojnë me nga 12 ore por ne një te ardhme qe te plotësohen këta me numër te mjaftueshëm te zyrtareve policore dhe te vazhdohet edhe me tutje edhe me investime mirëpo edhe me njësi patrulluese qe te ketë mundësi sa ma te mire për ndalimin e keqbërësve.

#### IV. Të ndryshme-

**FSK Major I.Demiri** - deshta te bej vetëm një njoftim qe FSK-ja do te organizoj ceremoninë e shënimit te "Ditës se FSK-se". Ky manifestim do te organizohet ne Kazermën "Adem Jashari" ne Prishtinë, me datën 27.11.2018, nga ora 10:00 deri ne ora 13:00, ndërsa aktivitetet për këtë dite do te ketë edhe ne te gjitha Kazermat tjera të FSK-së, do te hapin dyert për te gjithë qytetarët te cilët dëshirojnë qe ti vizitojnë zonën administrative, pajisjet dhe kapacitetet ekzistuese te FSK-së. Meqenëse kryetari na ka nderu dhe çdo here ka marr pjese ne këto manifestime shpresoj se do te vij edhe kësaj radhe, jeni te ftuar te gjithë dhe ju njoftova se kjo do te jete një dite e hapur për te gjithë qytetaret e R.Kosovës .

**Avdyl Mustafa** - Unë kam dy pyetje për kryetarin. Pyetja e parë ka te beje se kur planifikohet zbatimi gjegjësisht vendosja e trafo stacionit ne Plemetin, a ekziston marrëveshja ne mes te komunës dhe KEDS-it. Pyetja e dyte ka te beje , e di qe ekzistojnë shume familje te rrezikuara ne Plemetin qe jetojnë neper baraka dhe ne kontejner, dhe çfarë zgjidhje mund te gjeje për sigurimin e lendeve djegëse për ketë periudhe për këto familje te rrezikuara.

**Kryesuesi** - Sa i përket çështjes te pyetjes se pare, ne e kemi nxjerr një vendim ne kuvend, KEDS-i ja ka parashtruar kërkesën komunës qe te lejohet ne parcelën ku ata kanë dashtë me instalu trafon dhe neve na është kthyer pergjigja negative sepse ajo parcele është pjese ose prone e Ministrisë se infrastrukturës, mirëpo ne i kemi udhëzuar që ata te vazhdojnë tek Ministria e infrastrukturës, ndërsa javën qe shkoj kemi pas nje takim dhe besoj qe gjate kësaj jave ata kanë me zgjedh si problem. Sa i përket çështjes se dyte, ne duhet me pa si mundësi çka mundemi mi ndihmu por mbi te gjitha çështjen e barakave e dimë ne të gjithë, ne se pari po bëjmë përpjekje qe me i zhvendose ata prej aty, me kriju mundësi qe edhe ata te kenë një banim te mire, mirëpo ju e dini edhe vet dhe jeni ne ngjarje rreth situatës me organizatat, pastaj me Ministrinë e kthimit dhe unë shpresoj qe S.Agjanqiqi, veç ju ka drejtu një kërkesë institucioneve përkatëse dhe po presim ndonjë përgjigje. Atëherë e shpalli te mbyllur. Faleminderit për pjesëmarrje.

Takimi përfundoi në ora 11:40.

Koordinatorë-Procesmbajtës

S. Hashani

Kryesuesi i KKSBS-së

Xhafer Gashi

